

# *Sistemi administrativ i qyteteve të Kosovës gjatë shekujve XVI-XVIII*

*Isuf Ahmeti\**

## **Abstrakt**

Periudha nga shekulli XVI e deri në fillim të shekullit XVIII, shënon një etapë të re me kushte dhe rrethana të reja historike për popullin shqiptar. Shoqëria shqiptare kishte humbur një pjesë të konsiderueshme të forcave vitale njerëzore dhe ishte zhveshur deri diku nga shtresat e zejtarëve, tregtarëve dhe ato kulturore. Nga ana tjetër, dukuritë e reja ekonomike e politike që lindën dhe vepruan pas pushtimit osman, siç qenë përgjithësimi i regjimit të timareve si njësi me ekonomi natyrale të veçuara, luftërat dhe ekspeditat ushtarake të vazhdueshme për forcimin e pushtetit osman, vënia në shërbim të armikut dhe feudalëve shqiptarë, copëzimi i madh politik-administrativ etj., u bënë shkaqet kryesore që ngadalësuan ritmet e zhvillimit ekonomik, shoqëror e kulturor të vendit, që ndikuan në ngadalësimin e dinamikës së aspekteve të ndryshme të jetës.

Hulumtimet arkivore për shkruarjen e këtij studimi janë fokusuar edhe në fonde të dorëshkrimeve orientale, cirilike dhe latine të ruajtura në biblioteka të Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë etj. Analiza studimore po ashtu është mbështetur në hulumtimet arkivore të fondeve orientale në Prishtinë, Sarajevë e Shkup. Mirëpo, burime të dorës së parë për hartimin e këtij punimi, gjithësesi mbesin ato që janë hulumtuar në arkiva të Turqisë, sidomos në atë të Stambollit dhe Ankarasë. Në kontekst të këtij hulumtimi shkencor, një interes të veçantë paraqet edhe ballafaqimi i tezave historike të historiografisë shqiptare me historiografinë serbe.

---

\* Prof. Asst. Dr. Isuf Ahmeti. Kolegji AAB, Prishtinë. Email: isuf.ahmetaj@aab-edu.net

Punimi ofron lëndë të begatshme burimore. Ajo përshkohet me një kronologji dhe qasje të përdorimit të teknikave bashkëkohore shkencore-metodologjike.

**Fjalë kyç:** *Vilajeti i Kosovës, Sanxhaku, administratë, territor, Prizreni.*

Gjatë shekujve XVI-XVIII qytetet e Kosovës kishin trashëguar tipare të jetës autoktone, mirëpo asokohe këto tipare, edhe pse me vështirësi, u gërshetuan me elemente orientale të ardhura nga pushtuesit-osmanët. Pra, qytetet e Kosovës të kësaj kohe, siç është e njohur, u zhvilluan nën ndikimin e dy qytetërimeve të mëdha, oksidental të krishterë dhe atij oriental-islam, nga të cilat jo vetëm që mori, por edhe ka dhënë kontributin e vet në zhvillimin e tyre. Duke qenë se qytetet e Kosovës në atë kohë morën tipare të reja dhe se atyre nuk u është kushtuar sa duhet rëndësi pikërisht këtyre aspekteve, tema në fjalë do të hedhë dritë në komponentin e errët të kësaj çëdhtëjeje, dhe se në lidhje me këtë çështje mbetet edhe shumë për tu trajtuar.

### ***Sistemi administrativ i qyteteve të Kosovës në Perandorinë Osmane***

Sistemi administrativ i Perandorisë Osmane ishte krijuar nën ndikimin e rregullimit administrativ të Perandorisë Bizantine. Para se të bëhej perandori, shteti osman ka pasur një administrim të thjeshtë. Për plot një shekull ai ka qenë një principatë-bejllëk. Si i tillë, nuk mund të kishte ejalet, si njësi administrative, por ndahej në njësi territoriale politike-në sanxhakë. Me pushtimin e Bursës, shteti osman krijoi një ejalet-Ejaletin e Anadollit, me bejlerbeun në krye. Bejlerbejt e parë të atij ejaleti qenë të bijtë e sundimtarit osman Orhan Gaziut, më përpara Sylejman pasha e më pastaj Murat beu (Murati I). Pas

pushtimit të Edrenesë (1363), shteti osman u bë perandori dhe Perandoria Osmane u nda në dy ejalet-Ejaleti i Rumelisë (Rum-ili do të thotë toka e romejve; kështu turqit e quanin Ballkanin) dhe Ejaleti i Anadollit (viset e Azisë së Vogël). Qendra të Ejaletit të Rumelisë kanë qenë një herë Edrenea (1362 ose 1371) dhe më pastaj Galipoli e Plovdivi; nga shek. XV qendra kishte kaluar në Sofje, për t'u bërë më në fund qendra e tij Manastiri. Ejaletet më vonë u quajtën vilajete, ndërsa bejlerbeu - vali.

Zgjerimi i Perandorisë Osmane, pas pushtimeve të realizuara në shek. XV, bëri të nevojshëm ndryshimin e organizimit të saj shtetëror. Për ta vënë atë mbi baza më të qëndrueshme administrative e juridike, gjatë mbretërimit të sulltan Sulejmanit II Ligjvënësi (1520-1566), u krye një organizim i ri i shtetit dhe u rishikuan e u plotësuan ligjet ekzistuese me urdhëresa të tjera në përshtatje me kushtet e reja, me synim që të arrihej në radhë të parë centralizimi i pushtetit në duart e sulltanit.

Në shek. XVI, pas pushtimeve që pat bërë në pjesën evropiane, kishte themeluar katër vilajete: të Rumelisë, të Timishorës, të Budimit dhe të Bosnjës. Rushiti (2004, f. 13) thekson se "kjo ndarje me ndryshime jo të mëdha mbeti në fuqi deri në vitin 1839, pra vitin e shpalljes së Reformave të Tanzimatit". Kështuqë, krahinat e Gadishullit Ballkanik u përfshinë në tri ejalet: ejaleti i Bosnjës në veri të gadishullit, ejaleti i Rumelisë në qendër dhe ejaleti i Detit në ishujt e detit Egje dhe në një pjesë të bregdetit jugor. Kështu, organizimi i Perandorisë, në pikëpamje politike-administrative, duke u nisur nga lart e poshtë, ka qenë i ndarë në ejalet ose bejlerbejllëqe, bejlerbejllëqet në sanxhakë, sanxhakët në kadillëqe ose kaza, kazatë në nahije e nahijet në fshatra.

Kemi vënë re se gjatë periudhës së pushtimeve osmane, themelimi i administratës osmane në regjionet evropiane ishte

një proces gradual. Midis trevës së organizuar si sanxhak nën sundimin e drejtpërdrejt osman dhe të trevës së hapur për luftë të shenjtë, ishte një zonë amortizuese, qoftë regjion kufitar ose shtet vasal. Bejlerët në kufi ishin më të pavarur nga qeveria qendrore sesa ata që ishin më afër kryeqytetit dhe rridhnin nga familjet si Evranuz Ogulari ose Mihal Ogulari, të cilët e udhëhiqnin qeverinë në bazë të trashëgimisë. Pozita e këtyre bejlerëve në Perandorinë Osmane ishte e ngjashme me pozitën e Osman Gazit nën selxhukët. Spahinjtë në regjionet e tyre ishin zakonisht skllevërit ose shërbëtorët e tyre. Inalxhik (2010, f. 200-201) thekson se “në shtetet vasale osmanlinjtë nganjëherë u jepnin dinastive autonomi në çështjet e brendshme, por i detyronin të paguanin taksë vjetore dhe siguronin forca plotësuese për fushata luftime. Ata preferonin që disa regjione të mbeteshin si bejllike kufitare ose principata vasale”.

### *Vuçitërna dhe Mitrovica gjatë administrimit osman*

Prej krahinës së Brankoviçit, të cilën turqit e pushtuan përfundimisht në vitin 1455, qe themeluar një sanxhak që së pari u quajt Vilajeti Vëllk dhe më vonë Sanxhaku i Vuçiternës ose i Prishtinës. Deri në fund të shek. XVI, selia e këtij sanxhaku gjendej në Vuçitërn. Ndërsa, në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane kanë qenë vetëm tre sanxhakë. “Më 1526-1528, sipas defterëve turq, kanë ekzistuar 31 sanxhakë. Në vitin 1540, në suazën e bejlerbejllëkut të Rumelisë kanë qenë 40 sanxhakë. Më vonë, numri i tyre përsëri zvogëlohet, sepse formohen elajetet e reja. Sipas Ali Çaushtit (1653), Elajeti i Rumelisë ka pasur 24 sanxhakë, ndërkaq në kohë të Abdul Kadirit, kazasker i Rumelisë (1667), kanë qenë 22 sanxhakë” (Rizaj 1969, f. 709-710).

Mitrovica gjer në shek. XVI ka qenë në suazën e nahijes së Zveçanit. Që nga gjysma e shek. XVI fillon historia e Mitrovicës,

si nahije e veçantë e nga dekadat e para të shek. XVII ajo shëndërrohet në kadillëk të veçantë. Jo vetëm udhëtarët e shek. XVII e XVIII, por edhe Haxhi Kallfa, mendon se Mitrovica është kufiri i Bosnjës dhe përtej fillon Rumelia. Këtë e dëshmon edhe Çelebiu (1967, f. 266-268). Ai thotë se “Mitrovica është kufiri ndërmjet Ejaletit të Bosnjës dhe të Rumelisë, respektivisht Zveçani është vendi ku mbaron Elajeti i Bosnjës”.

Rizaj (1969, f. 710) thekson se “sipas dëshmive të udhëtarëve nga shek. XVI dhe XVII dhe gjeografit turk Haxhi Kallfa, Mitrovica gjendej në kufirin midis Bosnjës dhe Rumelisë. Kjo do të thotë se një pjesë e hapësirës së saj më të gjerë ishte e inkuadruar në Sanxhakun e Vuçitërnës, i cili pësoi ndryshime të shumta; ka pasur disa emra dhe ka qenë në përbërjen e të gjitha pashallëqeve fqinje, për t’iu bashkuar më në fund përsëri atij të Rumelisë. Përpos Vuçitërnës, këtij vendbanimi të rëndësishëm urban në Kosovë, këtij sanxhaku, i kanë takuar edhe minierat e njohura Novobërda e Trepça. Gjykuar sipas një fermi të Mehmedit II të vitit 1479, në Trepçë duhet të kishte ndejur edhe kadiu”.

Pra, duke pasur parasysh burimet e njohura për ne, konstatojmë se territori i sotëm i Kosovës gjatë shek. XV, XVI e XVII ka qenë në suazën e tre sanxhakëve: të Vuçitërnës, të Prizrenit dhe të Dukagjinit, duke përjashtuar pjesën gjer te Mitrovica e Zveçani, e cila i përkiste pashallëkut (elajetit) të Bosnjës dhe pjesën gjer te Kaçaniku që i takonte Vilajetit, respektivisht Sanxhakut të Shkupit (nga gjysma e shek. XVI). “Në anën tjetër, Sanxhaku i Prizrenit dhe ai i Dukagjinit kanë përfshirë territore që sot janë jashtë kuadrin të Kosovës së sotme. Sanxhakët e përmendur kanë qenë të kufizuar me Sanxhakun e Shkupit, të Qystendilit, të Sofjes, të Krushevcit, të Bosnjës dhe me atë të Ohrit” (Rizaj (1969, f. 710).

Sipas një defteri të shkurtër nga koha e “Memetit II pushtuesit, i cili jep gjendjen e timareve në subashllëqe të

Vuçitërnës, të Llapit, të Obrovcit të Epërm, të Prishtinës, të Moravës dhe të Topolnicës, mund të konkludojmë se Sanxhaku i Vuçitërnës është formuar mu në kohë të sundimit të Mehmedit II, sepse subashllëqet e përmendura gjenden në Sanxhakun e Vuçitërnës (Rizaj (1969, f. 710).

Në fillim të shek. XVI Vuçitërna, Prishtina dhe Novobërda kanë qenë në kuadrin e Sanxhakut të Shkodrës, por në deceniet e para të shek. XVI (1520-1530) Vuçitërna përsëri paraqitet si sanxhak i veçantë, i cili shtrihej nga brigjet e lumenjve të Sitnicës dhe të Nerodimes gjer te malet e Kopaonikut dhe Gollakut (në lindje të Podujevës), e në jug gjer te Karadaku i Shkupit, duke përfshirë qendrat kryesore: Prishtinën, Vuçitërnën, Trepçën dhe Novobërdën. Vetë Vuçitërna më 1527/28 ka qenë has i sanxhakbeut dhe ka pasur pesë mëhallë të krishtera.

Në aspektin “administrativo-ushtarak Sanxhaku i Vuçitërnës ndahej në nahije, të cilat paraqitnin njësitë më të vogla të rregullta administrativo-territoriale e ushtarake të Perandorisë Osmane. Numri i nahijeve të Sanxhakut të Vuçitërnës asnjëherë nuk ishte i njëjtë. Deri në fund të shek. XVI në këtë sanxhak u shënuan mbi 30 nahije të madhësive të ndryshme, prej 1-2 fshatrash deri te ato me mbi 300 fshatra. Në aspektin administrativo-gjyqësor Sanxhaku i Vuçitërnës ndahej në kadillëqe apo kaza. Në bazë të burimeve osmane që njihen deri më sot, shohim se kadillëqet në këtë sanxhak u paraqitën nga gjysma e parë e shek. XVI” (Rizaj, 1988, f. 67).

Pas vitit 1540 Sanxhaku i Vuçitërnës i është bashkuar Ejaletit të Budimit, por në gjysmën e shek. XVI, sipas burimeve venedikase, përsëri përmendet nën administrimin e bejlerbeut të Rumelisë me qendër në Sofje. “Në vitin 1544 nahija e Llapit (has i Mehmed Pashës), ajo e Moravës, e Toplicës dhe e Belasicës edhe më tej kanë mbetur në domenin e Sanxhakut të Vuçitërnës. Të ardhurat e Vuçitërnës kapnin 20.132 akçe. Në

nahijen e Vuçitërnës kanë ekzistuar haset e bejlerbeut të Rumelisë, Kara Mehmed Pashës. Përkundrazi, fermanët në vitin 1554 dëshmojnë se Sanxhaku i Vuçitërnës është edhe më tej në domenin e bejlerbeut të Budimit, kurse në vitin 1560 nahija Obiliq është në suazën e Sanxhakut të Vuçitërnës. Edhe ligjet financiare nga koha e sulltan Selimit II zënë në gojë Sanxhakun e Vuçitërnës” (Rizaj, 1988, f. 67).

Kështuqë, Sanxhaku i Vuçitërnës administrativisht i takonte Ejaletit të Rumelisë deri në vitin 1541, kur i bashkëngjitet Ejaletit të sapoformuar të Budimit. Në kuadër të këtij ejaleti mbetet deri diçka para vitit 1565 meqenëse nuk e gjejmë në një regjistrim të sanxhakëve të Ejaletit të Budimit nga ky vit. Sigurisht atëherë ky sanxhak ishte kthyer prapë në kuadër të Ejaletit të Rumelisë. Një kohë të caktuar ky sanxhak i takoi Ejaletit të Timishoarës, pastaj shumë shkurt prapë atij të Budimit derisa në vitin 1582 i kthehet përsëri Ejaletit të Rumelisë, në kuadër të të cilit mbetet deri në fund të ekzistimit të vet si sanxhak i veçantë, dmth. deri nga fundi i shekullit XVII (Zirojević, 1974, f. 93-94).

Nga aspekti i shtrirjes territoriale, Sanxhaku i Vuçitërnës llogaritet si sanxhak relativisht i madh, mjaft i pasur dhe me pozitë gjeografike jashtëzakonisht të rëndësishme, si nga aspekti strategjik-ushtarak ashtu edhe tregtar. Duke i abstraktuar disa ndryshime të vogla territoriale, llogaritet se ky sanxhak gjatë gjithë ekzistimit të vet në pjesën verilindore kufizohet me Sanxhakun e Krushevcit, në jug-lindje me atë të Qystendilit, në pjesën jugore me Pasha-sanxhakun dhe Sanxhakun e Prizrenit, në perëndim me Sanxhakun e Dukagjinit dhe atë të Shkodrës. Sipas një shënimi të N. Todorovit (1960, f. 211-212) supozohet se “Sanxhaku i Vuçitërnës nga fundi i shek. XV ka përfshirë një sipërfaqe prej 5670 km katrore.” “Qendra administrative e Sanxhakut të Vuçitërnës ishte Vuçitërna, ndërkaq në një numër të vogël

defterësh osmanë si qendër tjetër e këtij sanxhaku krahas Vuçitërnës përmendet edhe Prishtina. Për këtë arsye ky sanxhak gjatë ekzistimit të vet nganjëherë quhej edhe Sanxhaku i Prishtinës, sepse selia e disa sanxhakbejlerëve ndodhej edhe në Prishtinë (krahas Vuçitërnës)” (Rizaj, 1988, f. 67).

Duke u nisur nga defterët kadastralë të shekujve XV dhe XVI bie në sy se nahija, krahas karakterit të saj administrativo-ushtarak, ngërthente në vete edhe karakterin ekonomik. Numri më i madh i pronave në kuadër të nahijeve të Sanxhakat të Vuçitërnës ishin timaret e spahinjve, mirëpo nuk ishin të pakta as zeametet e titullarëve të lartë dhe haset e sulltanit dhe vezirëve.

Numri i nahijeve të Sanxhakat të Vuçitërnës asnjëherë nuk ishte i njëjtë. Në fillim ky sanxhak i kishte vetëm 8 nahije, ndërkaq në gjysmën e dytë të shekullit XVII numri i tyre u shtua në mbi 30. Shtimi i numrit të nahijeve ishte rezultat, në të shumtën e rasteve, i copëtimit të atyre nahijeve që llogariteshin si më të mëdha, në mënyrë që të lehtësohej administrimi i tyre sidomos në kohën kur sistemi timar filloi të përjetojë krizat e para të tij. Karakteristikë themelore e nahijeve të reja, do të thotë e atyre që u paraqitën në shekullin XVI, ishte se ato nahije në krahasim me nahijet e shekullit XV ishin shumë më të vogla (Rizaj, 1988, f. 67).

Kështu, gjatë shekujve XV dhe XVI në kuadër të Sanxhakat të Vuçitërnës përmenden këto nahije: Tërgovishta, Kllopotniku, Dollci, Morava, Vuçitërna, Topollnica, Prishtina, Llapi, Novobërda, Ubici, Karatonllu, Zagorja, Bërkovishta, Prizreni (Perzerin), Janjeva, Sitnica, Dobriçani, Zveçani, Bellasica, Gllama, Jasenoviqi, Muçibaba, Banja, Leskovci, Ostrovica, Trebushnica, Bugarina, Kezminat, Stara Dosla, Sreska, Trepça dhe Gollaku (Rizaj, 1988, f. 84).

Gjatë shekujve XVI dhe XVII në kuadër të Sanxhakat të Vuçitërnës shfaqen këto kadillëqe (kaza): Novobërda, Prishtina,



Belasica (Kosova), Vuçitërna, Prokupla, Janjeva, Morava, Karatonllu dhe Trepça” (Ibid). Përcaktimi i sigurt i shtrirjes territoriale të secilës nahije dhe kaza të Sanxhakut të Vuçitërnës mund të bëhet vetëm atëherë kur të zbulohen dhe interpretohen të gjitha llojet e defterëve të regjistrimit (tahrir defterleri), sidomos ato të shekujve XVI dhe XVII. Spahinjtë, zaimët dhe funksionarët e tjerë të Sanxhakut të Vuçitërnës në shumicën e rasteve rrjedhin nga popullsia vendëse. Burimet osmane tregojnë se ky sanxhak ishte i banuar me popullsi të larmishme (shqiptarë, sllavë, vlllehë, turq, jevgj, etj.) të konfesionit mysliman, ortodoks dhe katolik.

Pas formimit të bejlerbejllëkut të Bosnjës, në vitin 1580, Sanxhaku i Vuçitërnës i bashkohet atij dhe në kuadrin e tij mbetet gjer në vitin 1607, kur përsëri i kthehet bejlerbejllëkut të Rumelisë.” (Ibid). “Duke u mbështetur në dy fermanë, nga viti 1581 e 1583, shohim se sanxhakbej i Vuçitërnës ka qenë Mustafa Beu, i cili ka qenë edhe akinxhi Beg” (Rizaj, 1988, f. 84).

Ajni Aliu (1610), pastaj Haxhi Kallfa (nga mesi i shek. XVII), Sanxhakun e Vuçitërnës bashkë me Prishtinën e paraqesin në domenin e Ejaletit të Rumelisë. Me fjalë të tjera, sipas Haxhi Kallfës, Sanxhaku i Vuçitërnës ka pasur gjashtë kadillëqe: Vuçitërnën, Prishtinën, Kosovën, Janjevën, Moravën dhe Novobërdën. Evlia Çelebiu, i cili e viziton Kosovën më 1661, Vuçitërnën e përmend si seli të sanxhakbeut dhe nënvizon se me kadillëqe të veta (Prishtinën dhe Novobërdën) gjendet në Ejaletin e Rumelisë. Sipas “Regjistrimit të kadillëqeve të Rumelisë (1667) në kuadër të Sanxhakut të Vuçitërnës janë numëruar këto kadillëqe: Prishtina, Prokupla, Novobërda, Morava, Janjeva dhe Koriça” (Rizaj, 1988, f. 84).

Një burim turk, nga fundi i shek. XVII (1699), në Sanxhakun e Vuçitërnës i shënon këto kadillëqe: Prishtinën, Moravën, Novobërdën, Janjevën dhe Trepçën (Rizaj, 1988). Ende nuk është konstatuar kur është suprimuar Sanxhaku i Vuçitërnës

dhe selia e tij ka kaluar në Prishtinë. Ky sanxhak, në shek. XVII, quhet edhe Sanxhak i Prishtinës, ndoshta për arsyen që ndonjëherë në Prishtinë ka qenë selia e Sanxhakut të Vuçitërnës.

Disa të dhëna nga mesi i shekullit XVII për Mitrovicën flasin si për një vend kufitar të Ejaletit të Bosnjës kundruall Ejaletit të Rumelisë. Ejaletit të Bosnjës i përkiste edhe kadillëku i Bërvenikut mbi Ibër. Ky kadillëk përmendet në regjistrimet e viteve 1667 dhe 1745, në të cilat pasqyrohet një gjendje me e vjetër. Në përbërjen e tij hynte edhe qyteti Zveçan. Zyrtarisht ky quhej Mitroviçaxhik (Mitrovica e vogël), sikurse edhe vetë Mitrovica (Rizaj, 1988).

Edhe në shekullin XVIII, Kadillëku i Mitrovicës hynte në përbërjen e Ejaletit të Bosnjës dhe përbëhej prej nahijeve të Mitrovicës dhe të Zveçanit. Nga fundi i shekullit XVII Sanxhaku i Vuçitërnës u suprimua dhe territori i tij iu bashkua Sanxhakut të Shkupit. Me këtë edhe Trepça i takoi këtij sanxhaku, i cili përfshinte Prishtinën, Banjën e Vjetër, Novi Pazarin, Hisarin e Ri, Llapin, Moravën, Vuçitërnën, Bellasicën dhe Janjevën. Më vonë sërish përmendet Sanxhaku i Vuçitërnës si njësi e pavarur administrative (Šabanović, 1943, f. 340, 354-355, 365).

### *Prizreni, Peja dhe Gjakova gjatë administrimit osman*

Sipas, disa të dhënave të studjuesit turk Gökbilgin (1952, f. 10) i cili thekson se Prizreni në fillim të shek. XVI ka qenë përkohësisht kaza e Sanxhakut të Shkodrës, por në një defter demografik të viteve 1520-1535, Prizreni paraqitet si sanxhak i pavarur. Do të thotë në deceniet e para të shek. XVI kufijtë e këtij sanxhaku dukeshin kështu: Lugina e Drinit të Bardhë, Lugina e sipërme e lumenjve Ibër dhe Lim dhe Novi-Pazari. Kurse, sipas Rizaj S (1984, f. 714) bazuar në defterin e vitit 1530

të ndarjes administrative të Ejaletit të Rumelisë, Sanxhaku i Prizrenit së bashku me Hasin shqiptar, që gjendet në afërsi, ndahet në katër kaza. Ndërkaq, sipas regjistrimit të vitit 1528 Sanxhaku i Prizrenit ka pasur tri kaza: Prizrenin, Tërgovishten (Rozhaja) dhe Foçën”.

Ndërsa, përfaqësuesit e Venedikut në gjysmën e shek. XVI Prizrenin e përmendin si sanxhak të Rumelisë. Sanxhaku i Prizrenit, siç shihet nga defterët e rëndësishëm (muhimme), edhe në vitet 1554-1571 gjendet në përbërje të Ejaletit të Rumelisë, në kuadrin e të cilit kanë qenë këto nahije: Tërgovishta dhe Bihori” (Rizaj G, 1989, f. 715).

Si përfundim, ne nuk kemi të dhëna të sakta se kur është formuar Sanxhaku i Prizrenit, mirëpo duhet supozuar që kjo të ketë ndodhur jo larg pas pushtimit, meqenëse Sanxhaku i Dukagjinit është formuar më vonë. Duket se me pushtimin e pjesëve jugore të Despotit serb, turqit formuan tre sanxhakë: Vuçitërnën, Prizrenin dhe Alaxha Hisarin (Krushevcin), të cilët i takonin Ejaletit të Rumelisë me qendër në Sofje. Mirëpo, tash është vështirë të thuhet se cilat nahije kanë hyrë, me rastin e formimit, në Sanxhakun e Prizrenit, meqë kanë ndodhur ndryshime të shpeshta administrative.

Prej burimeve të gjetura deri më tani, disa informata të sigurta i jep “Kanunnameja e Prizrenit e vitit 1570. Aty përmenden këto nahije: e Prizrenit, Hoçës (Hoça nahyesi), Tërgovishtës, Therthernes dhe e Bihorit.” (Kaleshi, 1957). Sipas Novakoviqit (1892, f. 56-58) “Sanxhaku i Prizrenit ka përfshirë në shekullin e XVII këto kadillëqe: Prizren, Suharekë, Havas Prizren, Firxhova (Firçova), Bihor e Tërgovishtë”.

Kështuqë, “Kufiri ndërmjet Sanxhakut të Prizrenit dhe atij të Dukagjinit ishte kufiri perëndimor i Lumës te Ura e Vezirit, kështu që Bruti ku takohen Drini i Bardhë dhe i Zi i ka takuar Lumës, prandaj edhe Sanxhakut të Prizrenit. Duhet shtuar se Luma, sado që i takonte Prizrenit, nuk ka qenë kadillëk apo

nahije në vete në këtë periudhë.” (Kaleshi H, 1961, 502). Për kadillëkun Havas Prizren, Haxhi Kallfa thotë se është një “kadillëk i posaçëm që i takon këtij sanxhaku” (Kaleshi H, 1961, f. 502).

Nga dokumentet e Arkivit Shtetëror të Stambollit Mühimme Defterleri (BBA., Nr. 8 dok. 266) shihet, nga ana tjetër, se “Ky kadillëk është quajtur edhe Havass-i humayun (haset mbretërore) dhe Gora-ve Havas-i Prizren (Gora dhe haset e Prizrenit), apo vetëm Haslar (haset). Kështu, nga një dokument i vitit 1576, drejtuar bejlerëve të disa sanxhakëve të Rumelisë kërkohet që të nisen me ushtri kundër kryengritësve në fshatrat e Hasit në kazanë e Prizrenit, të cilët kishin bërë kryengritje dhe kishin plaçkitur kafshët e popullsisë”. Në dokumentin tjetër të vitit 1585, “u jepet urdhër kadilerëve të Ohrit, Tetovës e Dibrës që t’i kapin rebelët që kishin plaçkitur çifllikun e vezirit Koxha Sinan Pashës në hasin e Prizrenit dhe kishin marrë me vete kuajt, qetë e dhentë.” (BBA., Nr. 8 dok., 60). S’ka dyshim, pra, se ky kadillëk që përfshinte Opojën e Gorën, ka marrë emrin haslar mbasi ishin pronat mbretërore dhe të Vezirit të Madh.

Në një dokument (BBA., Nr. 8 për vitin 1540-1570) përmendet “Nahija Foça në Sanxhakun e Prizrenit”, ndërsa në kanunnamenë e Prizrenit përmendet Hoça. Kjo nahije përfshinte vendet në veri të Prizrenit, në anën e djathtë të Drinit. Ndër fshatrat e tjera, kjo nahije përfshinte fshatrat Rahovec, Hoçë e Madhe, Hoçë e Vogël dhe Brestovc. Në secilën nahije apo kadillëk përmendet Thertherne, ashtu si përmendet edhe në kanunnamenë e Prizrenit, mirëpo nuk kemi mundur të zbulojmë asgjë, sikurse pohon edhe vetë studiuesi Kaleshi. Ndërkaq, kadillëku Bihor i takonte vazhdimisht Sanxhakut të Prizrenit.

Në dokumentin (BBA., Nr. 8 dok. 920) e vitit 1560 përmendet Nahija e Bihorit dhe dizdari (komandanti i fortesës), Murati. Më 1570 përmendet gjithashtu kjo nahije, ceribasha i së cilës

kishte një timar (pronë, feud) të ardhurat e të cilit ishin 7.500 akçe.". Ndërsa, në vitin 1582, Sanxhaku i Prizrenit kishte tri kaza: të Prizrenit, të Tërgovishtës dhe të Hoçës së Vogël. Nahija e Hoçës së Vogël përfshinte shumicën e vendbanimeve të komunës së sotme të Rahovecit.

Studiuesi Osmani J (2003, f. 37) thekson se sipas "Deferit të hollësishëm nga viti 1590/91, Sanxhaku i Prezrenit kishte 5 nahije: Prizreni, Suhareka, Hasi, Hoça, Bihori dhe Tërgovishta por më vonë hynë edhe Nahija e Opojës". Ndërsa, në dokumentin (BBA., Nr. 29 dok. 167), theksohet se gjatë vitit 1591 "të gjitha vendbanimet e Anadrinit kanë qenë nën sundimin administrativ të Nahijes së Hoçës së Vogël, në të cilën kanë ekzistuar 96 fshatra. Edhe fortesa Tërgovishtë gjithashtu i takonte vazhdimisht Sanxhakut të Prizrenit. Ky kadillëk ishte njëfarë zone kufitare ndërmjet Sanxhakut të Prizrenit dhe pashallëkut të Bosnjës. Nga një urdhër drejtuar sanxhakbeut të Prizrenit, në vitin 1576, shihet se shumë rebelë e kaçakë nga Bosnja kalojnë në nahijen e Tërgovishtës dhe aty gjenin strehë. Prandaj, kërkohet që të ndalohej çdo hyrje në këtë kadillëk."

Studiuesi Jastrebov (1876, f. 7) sqaron se "nga fundi i shekullit të XVI dhe fillimi i shekullit XVII Sanxhaku i Prizrenit ishte në kudadër të Ejaletit të pashallëkut të Budimit". Mirëpo, të gjitha gjasat janë se Prizreni do të ketë qenë i varur deri diku nga ky ejalet në pikëpamje ushtarake, sepse pashallëku i Budimit, për shkak të pozitës së tij, kishte prioritet mbi të gjitha bejlerbejllëqet e tjera. Që sanxhakbeu i Prizrenit të ketë luftuar vërtet nën urdhër të bejlerbeut të Budimit kemi një varg dokumentesh. Kështu, në një prej tyre, me datë 28 korrik 1626, thuhet se njerëzit e Estarhazit kanë vrarë disa njerëz të sanxhakbeut të Prizrenit, i cili ndodhej atëherë atje për të mbrojtur Budimin (Spaho, 1935, f. 70). Natyrisht, këtë e vërteton studiuesi Elezoviq (1950, f. 50-51) se "Sanxhakbeu i Prizrenit me ushtrinë e vet ka marrë pjesë edhe në luftime të

tjera të mëdha. Kështu, nga tetori i vitit 1570 kur Turqit sulmuan përsëri Qipron, që ndodhej në duart e venecianëve, midis ushtrisë së madhe shohim edhe atë të sanxhakbeut të Prizrenit.”

Prizreni, si duket, në vitin 1577 ka qenë në domenin e Sanxhakut të Bosnjës. Në të mirë të këtij konstatimi flet një ferman i dërguar beut të Bosnjës, me anën e të cilit ngarkohet ai personalisht të shikojë çështjen e minierës së rigjendur në afërsi të fortifikatës Vllastidin në Prizren. Pra, Prizreni, në atë vit, po të kishte qenë sanxhak i veçantë fermi do t'i ishte dërguar sanxhakbeut të Prizrenit e jo sanxhakbeut të Bosnjës. Në vitin 1580 Prizreni paraqitet si sanxhak i veçantë, por në kuadrin e Ejaletit të Bosnjës, ejalet ky që formohet po atë vit. Ndërkaq një burim turk nga viti 1607 tregon se Sanxhaku i Prizrenit gjendet përsëri në Ejaletin e Rumelisë. (Rizaj, 1969, f. 715). Sipas fermanëve të shek. XVI, të trajtuar nga Skënder Rizaj, sanxhakbejlerët e Prizrenit kanë qenë këta: Sulejman Beu (1554), Hizir Beu (1556), Mustafa Beu (1564), Mahmut Beu (1576) dhe Hazir Beu (1581).

Në fillim të shek. XVII, sipas njoftimit të Ajni Aliut, në Sanxhakun e Prizrenit kanë qenë: 1 has që jepte të ardhura vjetore 281,646 akçe, 17 zeamete (zeamet – pronë që jepte të ardhura vjetore 20.000 – 100.000 akçe) dhe 225 timare (timar – pronë që jepte të ardhura vjetore gjer 2.000 akçe) (Rizaj S, 1969, 715).

Ndërkaq, Osmani J (2003, 33) na jep disa informacione se në gjysmën e shek. XVII, sipas Haxhi Kallfës, Sanxhaku i Prizrenit ka pasur këto kadillëqe: Prizrenin, Suharekën, Hasin e Prizrenit, Kërçovën, Bihorin dhe Tërgovishtën. Në pajtim me një burim turk, nga viti 1667, në kuadrin e Sanxhakut të Prizrenit janë përfshirë këto kadillëqe: Kërçova, Bihori, Tërgovishta, Suhareka, Rahoveci dhe Hasi i Prizrenit. Kurse, sipas defterit të xhizjes për vitin 1689 Sanxhaku i Prizrenit

përfshinte këto kadillëqe: Prizrenin, Suharekën, Bihorin dhe Tërgovishtën. Kurse, Rizaj S (1969, 715) deklaroi se në vitin 1669 në Sanxhakun e Prizrenit janë numëruar këto kadillëqe: Prizreni, Bihori, Suhareka, ndërkaq Tërgovishta kësaj here përmendet si kadillëk i Jeni Pazarit.

Me pushtimin e territorit të sotëm të Kosovës nga osmanët (1455) dhe me vendosjen e administratës osmane në këtë anë, territoret e Pejës dhe të Gjakovës zunë të qiheshin Dukagjin, përkatësisht hynë në kuadrin e Sanxhakut të Dukagjinit, i cili është shtrirë midis Adriatikut dhe sanxhakëve të Hercegovinës, Vuçitërnës, Prizrenit dhe më vonë Shkodrës.

Njëherësh, studiuesi Rizaj S (1969, 715) sqaron se territoret e Pejës dhe të Gjakovës ishin pjesë të kësaj njësie administrative osmane deri më 1783, kur Sanxhaku i Dukagjinit pushoi së ekzistuari. Atëherë kuptimi gjeografik u ngushtua vetëm në nahijen e Pejës, e cila hyri në kuadrin e Sanxhakut të Shkodrës. Me përfshirjen e njërive të reja administrative osmane, përkatësisht të vilajeteve, Peja si qendër e kadiut osman hyri në kuadër të Sanxhakut të Prizrenit. Në vitin 1874 qyteti në fjalë hyri në kuadrin e Vilajetit të Kosovës.

Gjithshtu, Rizaj S (1969, f. 715) pohon se “pas pushtimit të Shkodrës (1479) menjëherë formohet sanxhaku, po me atë emër. Sanxhakut të Shkodrës së posa krijuar i bashkohen disa vise të Sanxhakut të Dukagjinit. Kështuqë, në vitin 1490/91 Sanxhaku i Dukagjinit territorialisht ka qenë mjaft i kufizuar, dmth. në kuadër të atij sanxhaku nuk figuron asnjë vilajet, ndërkaq në suazën e Sanxhakut të Shkodrës kanë qenë këto vilajete: Shkodra, Plava, Peja, Altun Ili, Deçani, vllëhet e Pejës. Ndërsa, në fillim të shek. XVI Sanxhaku i Shkodrës është mjaft i zgjeruar, ashtu që në kuadrin e tij kanë qenë: Shkodra, Podgorica, Bihori, Peja, Vuçitërna, Prizreni, Prishtina, Novobërda dhe kazaja e Malit të Zi.”

Shënimi më i vjetër mbi Gjakovën, me sa dihet, daton më 1348. Kështuqë studiuesi Jireçek K (1959, f. 280), pohon se sipas Defterit të Sanxhakut të Shkodrës (1485), Gjakova ndodhej në kuadrin e kazasë së rrethit të Pejës, e cila ndahej në nahije të Pejës dhe të Altun-Ilisë, me qendër në Junik. Në atë kohë Gjakova hynte në zeametën e Hasan beut. Ndërsa, sipas Pulahës (1972, f. 186-187, 208-212) Gjakova në vitin 1571 ishte fshat me 63 shtëpi, në kuadrin e nahijes së Rudinës, të Sanxhakut të Dukagjinit. Kështuqë, Gjakova asokohe ishte has i sulltanit me të ardhura vjetore prej 8.000 akçesh. Sipas fermanit të vitit 1583, Gjakova ishte fshat në kuadrin e kadillëkut të Altun-Ilisë, të Sanxhakut të Dukagjinit. Gjithashtu, studiuesi Pulaha S (1972, f. 186-187, 208-212) sqaron se Gjakova deri në gjysmën e shekullit XVII në pikëpamje administrative varej nga kazaja e Altun-Ilisë, me qendër në Junik. Ndërsa, nga gjysma e shekullit XVII selia e kadillëkut gradualisht filloi të kalonte nga Juniku në Gjakovë. Pra, Gjakova më 1667 tashmë ishte kadillëk i veçantë dhe për nga lartësia e të ardhurave i takonte klasës VIII, me të ardhura mujore prej 4000 akçesh dhe kadillëku i Gjakovës ishte pjesë përbërëse e Sanxhakut të Dukagjinit (Pulaha, 1972).

Gjithashtu, mund të thuhet se: gjatë pushtimeve të tyre, osmanët i copëzuan së tepërmi trojet shqiptare, duke u dhënë njësisive ushtarake e administrative shqiptare një shtrirje territoriale më të vogël në krahasim me sanxhakët e tjerë të Rumelisë. Disa prej tyre, përveç popullsisë mbizotëruese shqiptare përfshinin edhe pakica malazeze, serbe e maqedonase.

### *Përfundimi*

Me pushtimin e territorit të sotëm të Kosovës nga osmanët (1455) dhe me vendosjen e administratës osmane në këtë anë, territoret e Pejës dhe të Gjakovës zunë të quheshin Dukagjin,



përkatësisht hynë në kuadrin e Sanxhakut të Dukagjinit, i cili është shtrirë midis Adriatikut dhe sanxhakëve të Hercegovinës, Vuçitërnës, Prizrenit dhe më vonë Shkodrës. Territoret e Pejës dhe të Gjakovës ishin pjesë të kësaj njësie administrative osmane deri më 1783, kur Sanxhaku i Dukagjinit pushoi së ekzistuari. Atëherë kuptimi gjeografik u ngushtua vetëm në nahijen e Pejës, e cila hyri në kuadrin e Sanxhakut të Shkodrës. Me përfshirjen e njërive të reja administrative osmane, përkatësisht të vilajeteve, Peja si qendër e kadiut osman hyri në kuadër të Sanxhakut të Prizrenit. Në vitin 1874 qyteti në fjalë hyri në kuadrin e Vilajetit të Kosovës.

Sundimtarja e kësaj treve, Perandoria Osmane, e zhytur prej kohësh në një krizë të thellë sociale ekonomike dhe e mundur radhazi ushtarakisht nga fuqitë kundërshtare, u detyrua t'i hapte portat e tregjeve të saj përpara presionit ekonomik të kapitalizmit perëndimor. Kështu, Evropa Juglindore, sidomos Rumelia, ku bënte pjesë edhe Kosova, për herë të parë në historinë e pushtimit osman fitoi një rëndësi shoqërore ekonomike dhe politike të dorës së parë. Ndërkaq, gjatë shekullit XVIII duken shenjat e mëtejme të dobësimit të Perandorisë Osmane në pikëpamje ushtarake-ekonomike dhe politike.

## *Referencat*

Akrimi Shtetëror i Turqisë BBA, (1570). *Mühimme Defterleri*. nr. 8 dok. Ankara.

Elezović, G. (1950). *Iz Carigradskih turskih arhiva – Mühimme defteri*. Beograd.

Inalxhik H., (2010). *Perandoria Osmane (Periudha klasike 1300-1600)*. (i përkthyer nga boshnjakishtja nga Hamdi Iljazi).

Jastrebov. (1876). *Sianan Paša i Kukli beg*. Glasnik srpskog učenog društva. knj. XLIII. Beograd.

- Jireček, K. (1959). *Zbornik Konstantina Jirečeka*. I. Beograd.
- Kaleshi, H. (1957). "Jedna prizrenska i dve vuçitrnske kanunname". *Glasnik Muzeja Kosova i Metohije*. II. Priština.
- Novaković, S. (1892). "Hadži Kalfa ili Čatib Čelebija turski geograf XVII veka". *Spomenik SKA*. XVIII, Beograd.
- Osmani, J. (2003). *Vendbanimet e Kosovës – Rahoveci*. Prishtinë.
- Pulaha, S. (1972). "Krahinat verilindore të Sanxhakut të Dukagjinit-Hasi dhe popullsia e tyre në gjysmën e dytë të shekullit XVI". *Gjurmime albanologjike – seria e shkencave historike*. II. Prishtinë.
- Rizaj, G. (1989). "Ndarja administrativo-ushtarake dhe gjyqësore e Sanxhakut të Vuçitërnës deri në fund të shekullit XVII". *Instituti Albanologjik (Gjurmime Albanologjike)*. Nr. 18-1988. Prishtinë.
- Rizaj, S. (1969). "Ndarja administrativo-ushtarake dhe gjyqësore e Sanxhakut të Vuçitërnës deri në fund të shekullit XVII". *Përparimi IX*. Prishtinë. 1969.
- Rizaj, S. (1982). *Kosova gjatë shek. XV, XVI dhe XVII*. Prishtinë.
- Rizaj, S. (1986). "Disa të dhëna mbi Gjakovën me rrethinë në kohën e administrimit osman". *Instituti i Historisë së Kosovës*. nr. 15. Prishtinë.
- Rushiti, L. (2004). *Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës 1878-1941*. Prishtinë.
- Šabanović, H. (1943). *Popis kadiluka u Evropskoj Turskoj od Mostaraca Huremovića*. GZM BiH. LIV. Sarajevo.
- Spaho, F. (1935). *Odnos bosanskog namjesnika prema budimskom veziru. Kalendar Narodne uzdanice*. vj. III.
- Todorov, N. (1960). *Za demografskoto, s' stojanie na Ballkanskija Poluostrov prez XV-XVI v.. Godišnik na Sofiskija Universitet*. Sofija.
- Zirojević, O. (1974). *Tursko vojno uređenje u Srbiji 1459-1683.*, Beograd.